

POZITA E SHQIPTARËVE NË MBRETËRINË SERBO-KROATE- SLLOVENE  
1918-1929

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I SHKENCËS NË HISTORI TË KOHËS SË RE

NGA:

ELVIRE NUREDINI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

Janar, 2023

## EKSPOZE E TEMËS

### POZITA E SHQIPTARËVE NË MBRETËRINË SERBO-KROATE- SLLOVENE 1918-1929

#### **Mentori**

**Prof. Dr:** Nuri Bexheti

**Kandidati/ja:** Elvire Nuredini

Qëllim i këtij punimit është që të pasqyrojmë në mënyrë më të detajuar “Pozitën e shqiptarëve në Mbretërinë Serbo-Kroate-Sllovene 1918-1929, ku planet e para për asgjësimin e shqiptarëve zëjnë një vend të merituar në kuadrin e këtij punimi. Kosova për një kohë të gjatë ka qenë pothuajse nën kontroll të pandërprerë ushtarak të rajonit nga ushtritë më të ndryshme, turqit, serbët, italianët, gjermanët, të cilët e kontrollonin me radhë këtë zonë të Ballkanit. Ndërsa veçmas kemi trajtuar lëvizjet e ndryshme të shqiptarëve kundër Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene gjatë viteve 1918-1929.

Punimi është i ndarë në katër kapituj. Në kapitullin e parë kemi trajtuar masat e para për shpronësimin dhe për shpërnguljen e shqiptarëve (1912-1915), ku janë përmendur edhe planëprograme të para për asgjësimin e shqiptarëve, gjithashtu është trajtuar edhe gjendja e Kosovës gjatë Luftës Së Parë Botërore, lëvizjet çlirimtare gjatë kësaj periudhe, si dhe për themelimin e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës.

Kapitulli i dytë përmban temë me mjaftë rëndësi të veçantë, ku është trajtuar ripushtimi serb në Kosovë, gjithashtu edhe çarmatimi i popullit të Kosovës nga ana e Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene, si dhe në kuadër të këtij kapitulli është trajtuar edhe gjendja ekonomike e Kosovës gjatë kësaj periudhe.

Në kapitullin e tretë është trajtuar fillimi i kolonizimit të tokave shqiptare nga Mbretëria SKS, zbatimin e Refomës Kolonizuese si dhe qëndresat e shqiptarëve kundër këtyre reformave ku në Kosovë qysh në fillim të vendosjes së organeve të para policore ushtarake në dekadën e dytë të tetorit, filloi edhe rezistenca e popullit. Kjo filloi të përhapet në çdo vend, mirëpo tani kishte më shumë karakter lokal. Rezistenca rritej çdo herë e më shumë pasi ishte dëshirë e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar

Në kapitullin e katërt janë trajtuar katër fazat lëvizjeve Kaçake, rëndësia e këtyre lëvizjeve, rolin e personaliteteve të ndryshme në këto lëvizje, gjithashtu është trajtuar edhe pjesa e krijimit të partisë së Xhemijetit si dhe veprimatri e kësaj partie.

Metodat e përdorura gjatë punimit të kësaj teme janë ato të sintezës, analizës dhe të krahasimit. Gjatë hulumtimit janë shfrytëzuar një numër relativisht i madh burimesh si nga autorë të huaj, ashtu edhe nga ata vendorë. Rezultatet e këtij punimi kanë të bëjnë më shumë me zgjerimin e njohurive lidhur me periudhën në fjalë sa i përket pozitës së shqiptarëve nën Mbretërinë Serbo-Kroate-Sllovene 1918-1929